



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 70/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.B, kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji, me seli në Prishtinë, rr. “Bekim Fehmiu”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh.M, për shkak të anulimit të vendimit nr. V_959_2018 të datës 29.03.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 12.10.2022 në prezencë përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 20.10.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. V_959_2018 të datës 29.03.2018 të nxjerrë nga i padituri Zyra e Rregullatorit për Energji.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KES/CO), ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) nr. V_959_2018 të datës 29.03.2018, si jo i ligjshëm, me arsyetimin se faturimi për muajin 06/2014 dhe 05/2015 është faturim i vlerësuar “E” si pasojë që konsumatori nuk ka ofruar qasje për lexim, andaj faturimi i bërë në muajin 07/2014 dhe 06/2015 është faturim me lexim dhe si pasojë janë faturuar kWh e shpenzuar në atë muaj dhe eventualisht kWh e muajit paraprak e nga kjo, KES/CO ka bërë shpërndarjen e kWh në muajt 06, 07/2014 dhe 05, 06/2015 kjo mbështetur edhe në raportin nga qendra e kalibrimit për njehsorin nr. 4694345 i cili ka rezultuar se ka qenë brenda kufijve të lejuar të matjes. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka shtuar se qëndrimet e të paditurit se konsumatori nuk ka mundur të shfrytëzoj në periudhat në fjalë as sa është faturuar vetëm për shkak se në muajt paraprak ka pasur shpenzim më të vogël, nuk mund të merret si qëndrim i saktë pasi që secili konsumator shpenzon sipas nevojave ashtu që në muajt e caktuar shpenzimi mund të jetë edhe më i lartë dhe në rastin konkret, shpenzimet në muajin

janar 2017 kanë qenë 519 kWh kurse një muaj më vonë – shkurt 2017 shpenzimet kanë qenë 373 kWh apo 39% më pak se në muajin paraprak, prandaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet padia e paditësit KES/CO ashtu që të shfuqizohet në tërësi vendimi i të paditurës ZRRE si i pabazuar.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i Bordit të ZRRE-së është nxjerrë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë si dhe të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë pasi që faturimi i bërë nga paditësi me vlerësim nuk ka qenë faturim real dhe në përputhje me dispozitat ligjore pasi që nga analiza e rrjedhës së energjisë elektrike vërehet se njehsori elektrik nr. nga muaji 03/2010 deri me 05/2013 ka regjistruar energji elektrik në dy tarifatat, ndërsa nga muaji 05/2013 e deri në ndërrim të njehsorit përkatësisht deri me 07/2015 ka regjistruar energji elektrike vetëm në tarifën e ulët, përveç 2 muajve 06/2014 dhe 05/2015 kur konsumatori është faturuar pa matje / paushall dhe ka regjistruar energji elektrike në të dy tarifatat. Gjithashtu ka theksuar se raporti i qendrës së kalibrimit nuk mund të merret gjithmonë meritore pa u bërë edhe analizat tjera të shpenzimit të energjisë elektrike ashtu që bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike të konsumatorit rezulton se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit para dhe pas periudhës kontestuese nuk ndryshon shumë, por ka ndryshim të madh në krahasim me shpenzimin mujor të muajit kontestuese 06/2015 me shpenzime mujore prej 2,640 kWh, ndërsa mesatarja e mujor e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën para periudhës kontestuese është 554.35 kWh/muaj dhe mesatarja mujore shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën pas periudhës kontestuese 07/2015 është 482.42 kWh/muaj. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar në tërësi pranë argumenteve të paraqitura në përgjigje në padi andaj ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe Vendimi i Bordit të ZRRE-së të mbetet në fuqi.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim ZRRE/DMK V_1619_09_17 i datës 08.09.2017; Kundërshtim i vendimit nga KESCO, nr. 2254 i datës 03.10.2017; Vendim i Bordit të ZRRE V_959_2018 i datës 29.03.2018; Transaksionet e konsumatorit S.B për periudhën 11.08.2006 deri me 05.05.2018; Rrjedha e njehsorit të energjisë aktive për konsumatorin S.B për periudhën 08/2006 deri 04/2018; Faturat e konsumatorit S.B për periudhën 08/2006 deri 04/2018; Procesverbal nr. 63/29 i datës 29.07.2015 nga Qendra e Kalibrimit; Protokoll mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik, nr. 02/8352 i datës 24.07.2015; Ankesë e konsumatorit S.B e datës 15.10.2015;

Vendim i KESCO nr. 884 i datës 02.10.2015; Formular i ankesës se konsumatorit i datës 29.06.2015; Procesverbal nr. 0617125 i datës 07.07.2015; Raport i KESCO për korrigjimin e shpenzimeve në dy faqe; Kontrate për furnizimin me energji elektrike për konsumatorët shtëpiak datë 29.06.2015, e pa nënshkruar nga konsumatori; Procesverbal mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0174843 i datës 10.07.2015.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thëniet në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Me Vendimin e Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK-së) ZRRE/DMK_V_1619_09_17 të datës 08.09.2017, është aprovuar ankesa e konsumatorit S.B, dhe është obliguar KES/CO që konsumatorin me shifër DPZ-903234 ta shkarkon nga fatura e muajit 06/2015 (fatura nr. 06150DPZ-9032345 e datës 26.06.2015) në vlerë financiare prej 202.86€ dhe për këtë muaj të ngarkoi konsumatorin në fjalë me shpenzimet e energjisë elektrike si të muajit 06/2016 (TL=255 kWh dhe TU=207 kWh) dhe në pikën II ka obliguar KESCO që konsumatorin me shifër DPZ-903234 për faturën e muajit 06/2014 (fatura nr. 06140DPZ-9032345 e datës 28.06.2014) ta shkarkoj dhe ta faturoj si konsumator i grupit tarifar 6 me shpenzim prej TL=0 kWh dhe TU=482 kWh, si dhe për faturën e muajit 05/2015 (fatura nr. 05150DPZ-9032345 e datës 27.05.2015) ta shkarkoj dhe ta faturoj si konsumator i grupit tarifar 6 me shpenzim prej TL=0 kWh dhe TU=465 kWh.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin, ka ushtruar kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, të cilët me Vendimin V_959_2018 të datës 29.03.2018 kanë refuzuar si të pabazuar ankesën e KES/CO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin S.B, me shifër të konsumatorit DPR – 90025040 dhe ka mbetur në fuqi vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_1619_09_17 i datës 08.09.2017.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 15 par. 1, nën-par. 1.8 dhe 1.9 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë të cilët përcaktojnë: *“1. Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: ... 1.8. të sigurojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të licencuarve me rregulla adekuate për zgjidhje të kontesteve; 1.9. të sigurojë se interesat në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë balancohen në mënyrë adekuate dhe se mbrohen konsumatorët në nevojë;”* si dhe në kuptim të nenit 17 par. 1 që përcakton se: *“1. Rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesat: 1.1. nga konsumatorët kundër të*

licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara;”. Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 14, 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë (Rregulla ZRRE/Nr. 04/2017 e datës 16 mars 2017) që përcaktojnë kompetencën e DMK-së pranë ZRRE për trajtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj vendimeve që merren nga furnizuesi apo operatori i sistemit si dhe kompetencën e Bordit të ZRRE-së për vendosjen për ankesat ose kontestet ndaj vendimeve të DMK-së.

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara.

Nga provat transaksionet e konsumatorit S.B për periudhën 11.08.2006 deri me 05.05.2018, rrjedha e njehsorit të energjisë aktive për konsumatorin S.B për periudhën 08/2006 deri 04/2018 dhe faturat e konsumatorit S.B për periudhën 08/2006 deri 04/2018, gjykata ka konstatuar se në periudhat kontestuese përkatësisht në muajin 06/2014 është regjistruar konsumi i energjisë sipas matjes elektrike me vlerësim (paushall) TL = 11 kWh dhe TU = 482 kWh apo shuma prej 15.66€ dhe për muajin 05/2015 është regjistruar konsumi i energjisë sipas matjes elektrike me vlerësim (paushall) TL = 2 kWh dhe TU = 465 kWh apo shuma prej 16.12€ ndërsa me për muajin 06/2015 është regjistruar konsumi i energjisë TL = 0 kWh dhe TU = 2,640 kWh apo shuma prej 202.86€. Gjithashtu nga këto prova, gjykata ka konstatuar se konsumatori S.B, në periudhën 06/2013 deri 07/2015 ka regjistruar shpenzim të energjisë elektrike vetëm në tarifën e ulët.

Nga prova procesverbal nr. 63/29 i datës 29.07.2015 nga Qendra e Kalibrimit, gjykata ka konstatuar se Qendra e Kalibrimit pranë paditësit ka bërë kontrollimin detal të njehsorit dhe është konstatuar se njehsori elektrik pllombën shtetërore dhe të prodhuesit i ka në rregull, nga ana e jashtme nuk ka dëmtime dhe në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi.

Nga prova protokoll mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik, nr. 02/8352 i datës 24.07.2015 gjykata ka konstatuar se Qendra e Kalibrimit e paditësit ka bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik nga ana e jashtme dhe ka konstatuar se njehsori elektrik ka pllombën shtetërore, nuk është i dëmtuar nga ana e jashtme, nuk e ka të djegur pjesën kyçëse dhe nuk e ka në prishje displein ndërsa është konstatuar se gabimi në matje në tarifën I ka qenë -1.23% dhe në tarifën II ka qenë -0.23%.

Nga prova Formular i ankesës së konsumatorit i datës 29.06.2015 gjykata ka konstatuar se konsumatori S.B ka paraqitur ankesë tek paditësi për shkak të leximit jo korrekt dhe leximit jo të rregullt të njehsorit elektrik për muajin 06/2015.

Nga prova procesverbal nr. 0617125 i datës 07.07.2015 gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë inspektim tek konsumatori S.B dhe ka konstatuar se konsumatori duhet ti bëhet rregullimi i gjendjes së tarifave dhe gjendjes financiare.

Nga prova procesverbal mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0174843 i datës 10.07.2015 gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik tek konsumatori S.B si dhe ka bërë regjistrimin e pajisjeve elektrike të konsumatorit.

Nga provat vendim i KESCO nr. 884 i datës 02.10.2015 dhe raport i KESCO për korrigjimin e shpenzimeve në dy faqe, gjykata ka konstatuar se paditësi ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe ka korrigjuar vlerën +15.63€ me datë 10.07.2015 si korrigjim mesatar i faturave të muajit 06/07 2014 dhe 05/06 2015.

Nga prova ankesë e konsumatorit S.B e datës 15.10.2015, gjykata ka konstatuar se konsumatori ka paraqitur ankesë tek i padituri kundër vendimit nr. 884 të nxjerrë nga paditësi.

Nga prova kontrate për furnizimin me energji elektrike për konsumatorët shtëpiak datë 29.06.2015, e pa nënshkruar nga konsumatori, gjykata ka konstatuar se paditësi ka përpiluar kontratën për furnizim me energji elektrike me datë 29.06.2015, përkatësisht në ditën e njëjtë kur konsumatori ka parashtrua ankesë për shkak të leximit jo të rregullt të njehsorit elektrik dhe e njëjta kontratë është e nënshkruar vetëm nga paditësi por jo edhe nga konsumatori.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit lidhur me faktin se është obliguar KES/CO që konsumatorin me shifër DPZ-903234 ta shkarkon nga fatura e muajit 06/2015 (fatura nr. 06150DPZ-9032345 e datës 26.06.2015) në vlerë financiare prej 202.86€ dhe për këtë muaj të ngarkoi konsumatorin në fjalë me shpenzimet e energjisë elektrike si të muajit 06/2016 (TL=255 kWh dhe TU=207 kWh) dhe në pikën II ka obliguar KESCO që konsumatorin me shifër DPZ-903234 për faturën e muajit 06/2014 (fatura nr. 06140DPZ-9032345 e datës 28.06.2014) ta shkarkoj dhe ta faturoj si konsumator i grupit tarifor 6 me shpenzim prej TL=0 kWh dhe TU=482 kWh, si dhe për faturën e muajit 05/2015 (fatura nr. 05150DPZ-9032345 e datës 27.05.2015) ta shkarkoj dhe ta faturoj si konsumator i grupit tarifor 6 me shpenzim prej TL=0 kWh dhe TU=465 kWh.

Gjithashtu gjykata e ka vlerësuar si të drejtë arsyetimin e ZRRE se nga prova rrjedhja e energjisë elektrike, konsumatori nga 06/2013 deri 07/2015 ka regjistruar shpenzim të energjisë elektrike vetëm në tarifën e ulët, përveç dy muajve 06/2014 dhe 05/2015 kur konsumatori është faturuar pa matje / paushall dhe ka regjistruar shpenzim të energjisë elektrike në dy tarifatat dhe se KESCO nuk është dashur që konsumatori me shifër DPZ-90032345 për periudhat 06/2013 deri 07/2015 ta faturoj me shpenzime edhe në tarifën e lartë.

Po ashtu gjykata e vlerëson të drejtë arsyetimin e ZRRE lidhur me shpenzimet e faturuar në muajin 06/2015 prej 2,640 kËh apo në lartësi prej 202.86€ pasi që nga analizimit i transaksioneve të konsumatorit, rrjedhës së njehsorit të energjisë aktive dhe faturave të konsumatorit S.B nuk rezulton se konsumatori nuk ka pasur shpenzim të tillë as të përafërt të energjisë elektrike në ndonjë periudhë para ndërrimit të njehsorit elektrik e as pas ndërrimit të njehsorit elektrik për çfarë gjykata nuk mund që ti falë besimin pretendimeve të paditësit lidhur me këtë rrethanë.

Gjykata vlerëson se një faturim / korigjim i tillë nga paditësi është në kundërshtim me nenin 29 në par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit i cili përcakton se: *“1. Faturimi i energjisë dhe i ujit llogaritet në bazë të konsumit real të lexuar në njehsorin e konsumatorit. Gjithashtu gjykata vlerëson se korigjimi i bërë nga paditësi është në kundërshtim edhe me Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji (Rregulla ZRRE/Nr. 12/2017, 13 prill 2017) në nenin 5 par. 1, pika 1.5 që përcakton se: “1. Në përputhje me dispozitat e kësaj rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të: 1.5. paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifatat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja;” dhe në pikën 1.6. përcakton se: “marrin kompensim nga furnizuesi, për energjinë e pa-dërguar ose për furnizim me energji të cilësisë së dobët dhe shërbim, që nuk është në përputhje me kontratën për furnizim me energji dhe standardet e furnizimit dhe shërbimit që iu ofrohen konsumatorëve.”*

Gjithashtu në nenin 28 par. 1, 2 dhe 3 përcaktohet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifatat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën*

e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit. 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.”

Prandaj, gjykata vlerëson se ZRRE ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit nr. ZRRE/DMK_V_1619_09_17 të datës 08.09.2017.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit se shpenzimi i regjistruar në muajin 06/2015 prej 2,640 kWh, ka mundur të jetë shpenzim i bërë në muajin paraprak për shkak të pamundësisë së leximit dhe i njëjti shpenzim është shpërndarë në muajt 05/2015 dhe 06/2015, por gjykata pas vlerësimit të provës Rrjedha e njehsorit të energjisë aktive konstatoi se konsumatori është faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike edhe për muajin paraprak, përkatësisht 05/2015 në sasi prej 465 kWh dhe po ashtu edhe në muajin pasues 07/2015 në sasi prej 466 kWh dhe gjithashtu për muajin 06/2015 në sasi prej 2,640 kWh, andaj gjykata gjeti se një argument i tillë nuk ka mbështetje në provat e administruara.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.70/22, datë 20.10.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.